

Rexhep Qasja

Dëshmitar
në kohë historike

Ditari

Ditari i REXHEP QOSJES
DËSHMITAR NË KOHË HISTORIKE
do të ketë nëntë vëllime,
që përmbledhin këto vite:

- 1. Vëllimi i parë 1966-1974**
- 2. Vëllimi i dytë 1975-1978**
- 3. Vëllimi i tretë 1979-1981**
- 4. Vëllimi i katërt 1982-1983**
- 5. Vëllimi i pestë 1984-1985**
- 6. Vëllimi i gjashtë 1986-1993**
- 7. Vëllimi i shtatë 1994-1999**
- 8. Vëllimi i tetë 1999-2001**
- 9. Vëllimi i nëntë 2002-2008**

REXHEP QOSJA
DËSHMITAR NË KOHË HISTORIKE
KOSOVA
Shtet i lirë, i pavarur dhe më vete
(2002-2008)

BOTIMET TOENA

REXHEP QOSJA

DËSHMITAR
NË KOHË
HISTORIKE

KOSOVA

Shtet i lirë, i pavarur dhe më vete

(2002-2008)

Libri i nëntë

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Përkujdesja grafike: Mirjana Madhi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN: 9789928376640

© Shtëpia Botuese Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

2002

1.1.2002

Gjergj Kastrioti.

Skënderbeu.

Si do të mbahet mend më gjatë?

Gjergj Kastrioti?

Apo

Skënderbeu?

Më i madh do të jetë numri i atyre që do ta quajnë

Gjergj Kastrioti?

Apo i atyre që do ta quajnë

Skënderbeu?

Nuk e di.

Por, e di se në historinë tonë kombëtare do të jetë i shënuar përgjithmonë:

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu.

Me këto mendime në mendje fillova ta qes në makinën e shkrimit tregimin me titullin ende punues *I Ringjalluri*. Këtij titulli punues ende nuk po mund t'ia gjej cilësorin. Herë e zgjedh cilësorin *i madh*, herë *i papritur*, herë *i dëshiruar* e herë *i penduar*.

E herë *I ringjalluri çlirues*.

Çlirimtar.

U çliruaam prej pushtuesit serb.

Por, jo edhe prej pushtuesit tonë të budallaftë!

Në orën 18:00 i dhashë pushim makinës së shkrimit.

Olivetit.

Por jo edhe vetes.

Vazhdoj të mendoj për cilësorët.

Më shumë.

Se sa për të Penduarin, më mendojnë cilësorët për të gjithë të tjerët - për ata që jetojnë mirë duke e shfrytëzuar emrin e tij!

Të gjithë cilësorët për të, për të Penduarin, përmbajnë cilësi.

Por, cilësorët për të tjerët që jetojnë mirë, o sa mirë, duke e keqpërdorur atdhetarizmin e tij historik përmbajnë shumë prishësi. Ata janë shumëçkaprishës! Që s' dinë të jenë ndjesëkërkues.

Koha është e ftohtë.

Bie borë.

Bora bën që ta përjetoj kohën më të ftohtë se ç'është në të vërtetë.

Desha të lirohem prej të ftohtit duke lexuar romanin *Lordi Xhim* të shkrimtarit të lavdishëm anglez, Xhozef Konrad.

Por, prej leximit të ftohtët m'u shtua.

Prej disa leximeve nxehe mi e prej disave ftohe mi.

2.1.2002

Qe tri ditë na është ndalur telefoni!

Nuk e kam të qartë pse na u ndal telefoni për Vitin e Ri!

Edhe dy javë para 28 nëntorit na është ndalur telefoni!

Miku im i vjetër XY më thotë:

- Lojën me telefonat, e atyre që e kritikojnë politikën e saj, e bëjnë sigurimsat e LDK-së. Prej vitit 1990 e deri në vitin 1999 këtë lojë ua besonin bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Brendshëm Shtetëror të Serbisë, kurse tani, ende, e bëjnë vetë!

- Ndoshta nuk do të mund ta bëjnë gjatë, - i them.

- Kush e di, - thotë i buzëqeshur dëshpërueshëm, me buzëqeshje të kithët.

3.1.2002

Deri në orën 13 rishikova tregimin për të *Ringjallurin...*

Acari i egër ma ndali punën.

Nuk kemi rrymë elektrike.

Këta pak rreshta të Ditarit po i shkruaj duke e pasur qiriun para syve.

Syzet e mia dhe qiriu përpara tyre nuk merren vesh kurrsesi.

Nuk po shoh.

Djathtas e Majtas, Para e Mbrapa - Mesjetë.

4.1.2002

Më vëllezërit Halilin e Isën dhe me nipin Valjetin shkuam në varrimin e motrës së Shpresës, Afërditës.

Bën acar siberian.

- Megjithëse jam veshur shumë trashë – me dy nënkëmisha, me setër stofi të trashë, me pallto prej stofi anglez, kam vënë një shall të gjatë që e kam mbështjellë rreth qafës dhe kam mbathur dy palë çorapë, njëren palë prej leshi e tjetrën “moderne”; prapë po mërdhij!

Për shkak se toka është e ngrirë, varri i Afërditës ka mbetur shumë i cektë!

Në të njëjtën kohë bëhet varrimi i tre të vdekurve. Dhe, të tria varret kanë qëlluar njëri afër tjetrit. Hoxhallarët e pengojnë njëri-tjetrin – aq janë afër shoqi-shoqit.

Në mbrëmje Shpresa u kthye në shtëpi. Është lodhur e bërë telef. Pas vdekjes së babait e nënës, kjo është vdekja e parë në shtëpinë e prindërve të saj. Prej dje as s’ka ngrënë e as s’ka fjetur.

Rryma elektrike, që u ndërpre mbrëmë, erdhi në mëngjes, në orën nëntë.

Shtëpia është akull e ftohtë.

Gjatë ditës dy orë me rrymë e katër pa të!

Jetojmë “qençe”, “qençe” në kryeqytetin e “Shtetit të ri”.

Mbasi u ktheva prej varrimit i bëra këto shënime dhe i bëra me qiri para syve e pastaj i rilexova faqet e qitura në makinën e shkrimit të tregimit satirik *I ringjalluri... I ringjalluri i penduar*.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu i ringjallur.

I ringjallur, por i penduar.

E kanë bërë të penduar pse është ringjallur ato që po sheh dhe ato që po dëgjon.

Me këtë tregim, të gjatë, do t'i sjell vetes shumë kundërshtarë e mes tyre edhe armiq, që do të më ballafaqojnë me të papritura që as t'i imagjinoj nuk jam në gjendje.

Megjithatë, dëshira ime për të thënë të vërtetën është shumë më e fortë se droja.

Me fjalë të tjera e thënë: Pasioni im për të zbuluar të këqijat dhe shëmtitë shoqërore të jetës shoqërore e të politikës është shumë më i fortë se frika prej të këqijave që mund të më bëhen.

Në qoftë se ka Zot është shumë i padrejtë.

Në qoftë se ka Zot nuk kuptoj pse nuk i sheh gjithë këto të këqija, këto padrejtësi, këto shfrytëzime që krijesave të tij “të vogla” u bëhen prej krijesave të tij “të mëdha”!

Në qoftë se ka Zot pse lejon të jetë kaq shumë mëkatar duke mos i dënuar shkaktarët e të këqijave dhe padrejtësive që u bëhen robërve të tij të pafajshëm prej të privilegjuarve të tij mëkatarë!

Po shkruaj në terr. Edhe Kosova po jeton në terr.

Njerëz mendjepaktë po i marrin në duar punët e Kosovës!

Njerëz mendjepaktë, që nuk shohin përtej duarve të veta e xhepave të vet, po i qesin nën këmbë punët e Kosovës!

Në mbrëmje acari të pret fytyrën si me brisk të rrojës.

Sado mërdhij, acarin e duroj më lehtë sesa vapën. Jam mësuar në dimrat e acartë të Vuthajve.

E martë 8.1.2002

Shkova në Zyrën e Shqipërisë për të uruar Vitin e Ri.

Me shumë vonesë!

Shkova me Valjetin.

Pa Shqipërinë në mendje s' e kam asnjë çast të ditës.

Na pritën Ladi dhe Shpëtimi.

Biseduam rreth një orë.

Përpos të tjerash edhe për mosmarrëveshjet, në të vërtetë, për konfliktin politik mes Fatos Nanos dhe Ilir Metës.

- Më e reja dhe më interesantja, - thotë Ladi, - është biseda e paralajmëruar mes Fatos Nanos dhe Sali Berishës. Por, pak kush beson se kjo bisedë e paralajmëruar mes tyre vërtet do të ndodhë.

- Është e mundshme, - i përgjigjem.

- Pse thua ashtu? - Më pyet.

- Sepse Nano dhe Berisha kanë tani të njëjtin kundërshtar, që është Ilir Meta, i cili iu duket më i fortë se ç'është.

Kur u çova të dal, thashë: - Kështu pa busull ecën historia jonë hane dane.

- Si?

- Na bashkojnë jo ato që duam po ato që s' durojmë!

Në Zyrë lashë një shishe të madhe konjak francez dhe dy kuti *Marlboro* në shenjë kujdesi për anëtarët e Zyrës.

Ladi deshi të më jepte veturën që të më çonte në shtëpi.

I thashë se e kam veturën, e kam lënë pak më tutje.

Kur me Valjetin shkuam në anërrugën ku e kisha lënë, vetura nuk ishte aty.

E kishte marrë e ashtuquajtura "Merimangë" – vetura ndëshkuese e policisë, për shkak të parkimit ku s'lejohej.

Valjeti thirri t'atin, Dulin, i cili erdhi shpejt. Polici më privilegjoi: ma dha faturën edhe pse dokumentet nuk i kisha me vete – i kisha lënë në veturë.

E morëm veturën mbasi paguam 63 marka gjermane.

Moti është i butë. Bora që kishte rënë është përlyer shumë.

Në mbrëmje më thirri Zonja Nermin Vlora Falaçi.

Mbasi i kryem fjalët përshëndetëse, Zonja Nermin më tha se tani duhet të përkthejë në italisht fjalën time për Ismail Qemalin. Unë, tha, do të lexoj një faqe, kurse pjesën tjetër të tekstit do ta lexojë i shoqi i saj. Prej fjalëve që shtoi kuptova se tekstin tim ende nuk e kishte marrë. I thashë se ia kam dërguar me 1 janar.

- Por, nuk më ka ardhur, - tha.
- Më vjen keq, - i thashë.
- E-maili nuk e kryen gjithmonë punën, - tha. - Dhe nuk e kryen kur teksti është i gjatë. E kam marrë urimin, po jo shkrimin, - shtoi.

E luta ta rishikojë e-mailin dhe në qoftë se nuk i ka mbërritur ia dërgoj me Fax.

E lamë të dëgjohemi të nesërmen, në orën 18:00.

9.1.2002

Nuk dola në Institut.

E rishikova, ngadalë-ngadalë tregimin satirik për ringjalljen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Në të vërtetë fillova ta rishikruaj. Do të më dalë më i gjatë se ç'mendoja: rreth 45 faqe të mëdha.

Ka pjesë të dobëta prandaj duhet ta ripunoj.

Shpresa rri te motra e madhe – Drita. Presin njerëz, që vijnë për ngushëllime, për vdekjen e Afërditës.

Shkova për drekë tek Isa.

Në mbrëmje, në orën 18, më thirri Zonja Nermin Vlora dhe menjëherë më tha se teksti im i ka shkuar ditën e dërguar – me 1 janar.

- Është tekst shumë i bukur, i jashtëzakonshëm, ju lumtë, - tha. - E keni vështruar prej disa anësh Ismail Qemalin e madh. Ju lumtë!

E falënderova, i gëzuar, për fjalët aq të mira.

Më pyeti si do të udhëtoj për në Romë.

- Nuk e di ende. Fluturime prej Prishtine për Romë ka vetëm të dielave e atë ditë nuk mund të udhëtoj.

- A të interesohem unë, - tha, - për ardhjen tënde e të shoqes suaj?

- Po mirë, - iu përgjigja.

E lamë që të dëgjohemi të hënën mbasi ajo të takohet me ambasadorin e Shqipërisë në Romë dhe të merren vesh për udhëtimin e kryetarit Meidani.

Prognozohet edhe një valë acari me borë. Mos acari do të ndodhë pikërisht ditën kur do të udhëtojmë për në Romë?!

Telefonin e shtëpisë, që ma kishin ndërprerë për Vitin e Ri, ma lëshuan sot, pas nëntë ditësh!

Pse e kanë ndërprerë nëntë ditë dhe pse e lëshuan tani para udhëtimit për në Itali nuk e kuptoj. Nuk kuptohen lehtë punët e policive të fshehta partiake!

10.1.2002

Paradite dola në Institut.

Është ftohtë.

Është keq.

Është kohë e padurueshme në kushte të padurueshme.

Nuk mund të punoj.

Në mendje më gërryen ideja e romanit të ri.

E thirra Fatmirin, Fatmir Toçin.

I tregova se ia kam çuar me e-mail sprovën për Ismail Qemalin.

Më tha se e ka marrë.

Më tha se e ka thirrur Nermin Vlora dhe i ka thënë se është mirë që edhe unë të udhëtoj prej Tiranës për në Romë.

I ka thënë se të gjitha shpenzimet për udhëtimin tim e të shoqes sime dhe për qëndrimin tonë në Romë do t'i heqë Akademia që më ka ftuar.

Pasdite shkova shkurt në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës.

Deputeti i Aleancës Demokratike, ZY Çollaku, kërkoi të formohet një Komision i cili do të verifikojë të dhënat biografike për kandidatin për kryetar të Kosovës, Ibrahim Rugova. Tha se në mbledhjen e kaluar ish- gjykatësja Nekibe Kelmendi ka folur vetëm për njërën anë të biografisë së kandidatit. Komisioni duhet të na tregojë edhe anën tjetër të tij: ku ka qenë Rugova gjatë luftës, cili ka qenë qëndrimi i tij ndaj UÇK-së dhe ndaj bombardimeve të NATO-s kundër forcave ushtarake dhe formacioneve të tjera të armatosura serbe në Kosovë? Dhe sa herë është takuar me kriminelin e luftës Millosheviq dhe me bashkëpunëtorët e tij?

Këto të dhëna shtrojnë pyetjen: a mund të bëhet simbol i unitetit një njeri me këso biografie?!

Deputeti Muhamet Kelmendi foli me patos të njohur komunist-leninist. E shkeli gjuhën pa mëshirë!

Deputetja Melihate Tërmkolli foli me gjuhën dhe me stilin e komunistëve të Titos.

Zëri mashkullor. Dhe frizura mashkullore!

Më së mençmi foli një deputet turk, i quajtur Bislim Hoti. Edhe shqipja e tij si e Muhamet Kelmendit - për ta vajtuar Rahoveci!

Dikur e mori fjalën kryetari i Kuvendit, Nexhat Daci, të cilin kryetar e ka bërë fqinji i tij, Ibrahim Rugova. Dhe menjëherë tha:

- Jemi duke punuar qe një orë e jemi lodhur dhe e meritojmë pauzën e kafesë. E paguaj unë, - tha!

Disa deputetë e përcollën me gaz këtë humor banal të kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Mjerë Kosova!

O Kosovë e shkretë! Shpejt u bëre të të vajtojë Rahoveci.

Bashkëshakaxhiu i Dacit, Rugova, nuk i mori votat as në mbledhjen e sotme të Kuvendit. Por, do t'i marrë në mbledhjen e ardhshme. Lidhja Demokratike e Kosovës është trashëgimtare e Lidhjes Komuniste dhe i ka të kryera shkollat nëntokësore të shërbimeve e veprimeve të saj partiake e policore.

Prej disa diskutimeve të disa deputeteve, të disa partive, shihet se sa lirë në këtë Kuvend shitet nderi i Kosovës!

Kur u krye mbledhja dhe u nisa të dal m'u afrua njëri prej mysafirëve që kishte qenë në galerinë jo larg prej meje dhe m'i pëshpëriti dy vargje, që nuk i kisha dëgjuar ndonjëherë:

Moj Kosovë e mjera Kosovë

Kush po ta shtjer kryet në katrovë!

Vargje banale për një mbledhje banale, mendova!

11.1.2002

Sot pasdite ma lëshuan telefonin me numër të ri 249-369.

E ai që më tregoi numrin, ai edhe ma uroi.
Tërë ditën e kalova duke e rishtypur për të satën herë tregimin
satirik për Ringjalljen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.
U paraqit me telefon Fatmiri. Fatmir Toçi.
Vijnë me Irenën - nesër mbrëma.

12.1.2002

Dje ma lëshuan e sot, prapë, ma ndalën telefonin! Telefonin e
ri!

Allah! Allah!
Kush po e bën këtë lojë vetëqeverisëse?
Kush po e bën këtë lojë udbiste?
Kuptohet, UDB-a e re!
Shërbimi sekret i LDK-së.
Është urdhëruar prej udhëheqjes të më terrorizojë në mënyrë
telefoniste! Neofashiste dhe neostaliniste!

Nuk e dinë të shkretët se mendja ime, dhe shpirti im, dhe
dhuntia ime e përjetojnë si mjerim të tyre banal terrorin e tyre
telefonizues! Por, dreqi e i biri mund ta dinë si do ta vazhdojnë
këtë terror!

13.1.2002

Edhe sot e rishtypa në makinën e shkrimit tregimin satirik.
Më mbetet pa kryer përfundimi. Nuk e harroj mendimin teorik:
përfundimi e zbukuron, por përfundimi edhe mund ta prishë
veprën. Jo pak fjalë janë të kota në tregim. Do përpunim të
kujdesshëm, shumë të kujdesshëm. Do stilizim, stilizim, stilizim
të ri. Gjatësinë nuk mund ta zvogëloj e as ta shtoj për më pak a për
më shumë se dy-tri faqe.

Më thirri Nermin Vlora.

E ka marrë e-malin e Fatmirit dhe ka parë se udhëtojmë të enjten, në të vërtetë të mërkurën në mbrëmje prej Durrësit me traget. Thotë se mund të vonohemi. Duhet të mbërrijmë në Romë së paku 24 orë para fillimit të akademisë. Është e shqetësuar mos përkthimi i tekstit tim dhe i tekstit të Meidanit në italisht nuk do të dalin mirë dhe nuk do të dalin mirë, sepse nuk e di sa njihet gjuha letrare italiane në Shqipëri. Do të donte t'i shihte vetë përkthimet e të dyja teksteve.

14.1.2001

E hënë.

U zgjova me dhembje të forta në kryqe. U detyrova ta lë për sot punën me makinën e shkrimit. Këto dhembje, frikësohem, mund të më pengojnë të udhëtoj për në Itali. Do të shtrëngoj dhëmbët e do të udhëtoj edhe me dhembje se përndryshe bëhem horë!

Është shumë ftohtë.

Lexoj i shtrirë në shpinë!

Marr shënime në shpinë!

Pi ujë në shpinë!

Kafshatën e përpij duke e kthyer gojën anash, në anën e djathtë.

E në shpinë më ka dalë disku mes unazës së katërt e të pestë.

E shkreta kjo shpinë.

Nuk u jam përkulur të këqijave politike, shtetërore, shoqërore e të tjera e tani po i përkulem natyrës.

Po mirë, mirë! Nuk është turp të pësojmë disfatë në betejat me natyrën. Ajo është më e fuqishme se ne – njerëzit.

Nuk mërzitem. Kam jetuar mjaft, edhe pse do të mund të krijoja edhe vepra të tjera shkencore e letrare. Natyrisht, në qoftë se më dhurohet edhe ndonjë vit jetë.

15.1.2002

Nuk dola në Institut. Nuk jam në gjendje të dal.

Lexoj i shtrirë në shpinë.

Marr shënime në shpinë.

Në shpinë e shikova romanin e Italo Kalvinos *Dita e anëtarit të komisionit zgjedhor* dhe, mandej, nisa ta lexoj sërish, pas ndoshta tridhjetë vjetësh, romanin *Konti i përgjysmuar*. Ndoshta titullin e këtij romani të tij të dytë e përktheva gabimisht.

Kalvino ishte komunist, komunist që nuk ishte liruar prej disa iluzioneve komuniste. E kuptueshme. Kalvino ishte intelektual i vërtetë, i madh. Ne lirohemi lehtë e shpesh jo vetëm prej iluzioneve, por edhe prej bindjeve. Kalvino ishte gjeni krijues dhe kjo dhuratë e madhe, me të cilën e kishte stolitur nëna natyrë, i ka bërë të mundshme që t'u shpëtojë rreziqeve me të cilat ideologjia e cenon vlerën e letërsisë, të shkencës e të filozofisë.

Në veprat e tij lexoj çdo gjë që është e pazakonshme, në të vërtetë e jashtëzakonshme. Të pazakonshme, të jashtëzakonshme janë: temat, mendimet, pamjet, gjuha, stili, figurshmëria, ngjyresat, përgjithësimet, përimtimet. Mendimet e tij janë mendime me shumë-shumë ngjyresa. Patosi etik i romaneve të tij është i fuqishëm, por kurrë i shtirë dhe, duke mos qenë kurrë i shtirë, është gjithnjë artistikisht i natyrshëm, i arsyetuar, i bindshëm.

Në Shqipëri vazhdon sadopak i zbutur dyluftimi politik Fatos Nano - Ilir Meta.

Sali Berisha i mbledh lekat politike që Fatos Nano dhe Ilir Meta ia shqyejnë njëri-tjetrit.

Papërgjegjësi politike!

Papërgjegjësi shtetërore!

Papërgjegjësi kombëtare!

Të gjitha papërgjegjësitë politike, shtetërore e kombëtare të politikanëve, të partiakëve e shtetarëve shqiptarë, i paguajnë shqiptarët e sunduar prej tyre – prej politikanëve, partiakëve, shtetarëve!

Çfarë shtetarësh!

Në Shqipëri papërgjegjësi e trefishtë.

Në Kosovë diletantizëm politik i trefishtë.

Si mospajtimet, ashtu edhe pajtimet e kryetarit të LDK-së,

Ibrahim Rugova, janë të privuara prej dinjitetit politik. Si në pajtimet, ashtu edhe në zënkat e tij në vend të vendosmërisë ka mjerim. Vetëm mjerim. Ai s'di të jetë kurrë as akull i ftohtë, as zjarr i nxehtë! Ai është gjithmonë i vakët. E i vakët dihet kush është e çka është!

Shefi i zyrës amerikane në Prishtinë u këput duke u përpjekur që t'i bëjë arrivistët tanë të aftë për krijimin e institucioneve shtetërore jo me retorikë, por konkretisht. Këto përpjekje të tij janë fryt i bindjes se heronjtë tanë politikë, partiakë e shtetërorë, institucionet shtetërore i njëjtësojnë plotësisht me karriget e tyre.

16.1.2002

Dola në Institut, i përdredhur, si të më kishte shituar zana! Qëndrova pak në zyrë dhe shpejt u ktheva në shtëpi. Nuk mund të qëndroj as në këmbë, as ulur! Vetëm në shpinë! E shkreta shpinë! Po i paguan haraç mospërkuljes. Vertikalizmit.

17.1.2002

Fryn jugu dhe shkrihet bora.

Mendoj: si do të udhëtoj për në Romë?

E kuptoj Fatos Nanon duke e lavdëruar Ilir Metën në *Zërin e Amerikës* mbrëmë. Deri pardje e quante kryespekulues, shef të të korruptuarve, kurse mbrëmë e ndërroi pllakën dhe gjuhën për të dhe e shenjtësoi. Kështu luajnë koqe me politikën *politiçarët* tanë!

Me politikën dhe me popullin.

Çka mendojnë shqiptarët për këto varavinga të kryeministrit të Shqipërisë, Fatos Nano?

Çka mendojnë diplomatët e huaj në Tiranë për këto piruete teposhtë e përpjetë të kryeministrit të Shqipërisë, Fatos Nano?

A mendon Fatosi ynë çka mendojnë votuesit shqiptarë dhe çka mendojnë diplomatët për ndryshimet aq të shpejta e aq rrënjësore të mendimeve të tij për të njëjtin politikan e shtetar shqiptar!

Romani *Konti i përgjysmuari* i Italo Kalvinos – vepër gjeniale. Gjeniu gjithmonë është i jashtëzakonshëm – kurdo e kudo. Sa shumë gjeniu i ka dhuruar Italia letërsisë botërore.

Sa kretenin i dhurojnë politikës Shqipëria dhe Kosova! Dhe, Serbia! Dhe, Maqedonia! Dhe, Mali i Zi!

18.1.2002

RTK-ja, Televizioni i Kosovës, njofton se mbrëmë rreth orës 20 në Pejë është vrarë një deputet. Është vrarë deputeti Smajl Hajdaraj.

A jemi në vete ne? A pak vrasje e masakra na bëri Serbia e tani duhet të vrasim edhe njëri-tjetrin!

RTK-ja jep plot njëzet e një minuta lajme, reagime dhe komente për këtë vrasje.

Fjala e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ishte fjalë tragjike e komike. Si të gjitha që i thotë ai! Foli për do “janara”, për do “reciklime” në politikën e Kosovës. Dhe foli me patos e me retorikë banale siç di ky profesor fakulteti të banalizojë çdo gjë e çdokë që merr në gojë.

Zëvendësadministratori i Kosovës, emri i të cilit nuk po më kujtohet, vizitoi kryetarin e LDK-së në vend që të vizitonte kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe kjo vizitë e tij ishte benzinë e hedhur në zjarr! Vizita e tij zgjati njëzet e një minuta. Në vend se me bashkëbiseduesin ta qetësonin, ata, bashkë, e ashpërsuan shumë situatën. Më në fund ende nuk dihet me siguri nëse ishte kjo vrasje politike apo farë hakmarrjeje: për mezhdë, për kullosë, për arë, për livadh, për borxh, për gjak të vjetër a urrejtje të re. Pavarësisht nga motivi i vrasjes, ky ishte një krim, krim i rëndë, që i rëndon shumë marrëdhëniet tona të ndërsjella politike, që e dëmton shumë politikën tonë, që e dëmton shumë kulturën tonë të shkretë demokratike dhe të mjerë shtetkrijuese.

Në politikën e Kosovës, sidomos prej viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, janë futur jo pak njerëz të liq. Disa prej tyre,

me role prijëse, janë bërë kobi i Kosovës edhe pse malukati i quan krenaria, mburrja, lavdia e Kosovës!

Kryetari i LDK-së nuk linte gjë pa bërë për t'u bërë kryetar i Kosovës - edhe dje kur Kosova ishte autonomi e shtrydhur, e shtypur, e fikur, e kamxhikosur e Serbisë, edhe sot kur Kosova është protektorat i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Dhe, nuk lodhet aspak pse me këto përpjekje të tij, me këtë kryetarësi të tij, e zhburrnon dhe e çnderon dhe e zhdinjtetëson Kosovën!

19.1.2002

Kur i dëgjon njeriu lajmet për luftën dhe për luftëtarët e UÇK-së krijon përshtypjen se në UÇK kishte vetëm komandantë e jo edhe ushtarë. E komandant, u tha në lajme, ishte edhe deputeti Smajl Hajdaraj, që u vra mbrëmë në Pejë.

20.1.2002

Nuk kemi rrymë elektrike, prandaj KTV-ja nuk e merr programin satelitor.

RTK-ja. Televizioni i Kosovës e fillon programin e sotëm me një program të quajtur humoristik. Një djalosh me setër në kokë, domethënë me sy, me gojë e me kokë, në tërësi të mbuluara, u del përpara veturave e furgonëve. Dhe, kështu symbyllur, gojëmbyllur e kokëmbulluar, duke kërcyer si kangur, zbavit qytetarët që e shikojnë KTV-në dhe, sidomos, udhëheqjen e Televizionit.

Ja kështu, me këtë humor të zi, që mund të përfundojë tragjikisht, e fillon programin e tij Televizioni ynë.

Me kësi kiçi, kësi shundi, kësi gazi banal na uron ditën e natën Televizioni ynë.

Po shtohet kiçi, po shtohet shundi, po shtohet gazi banal në të gjitha fushat e jetës sonë.

Dhe, po shtohen, po rriten, po përhapen kiçi, shundi, gazi banal, në të gjitha fushat e jetës sonë, sepse po shtohet numri i

kiçnjerezve në medie, në kulturë, në universitete, në publicistikë, në shkencë, por sidomos në politikë, në parti, në protektoratin që do të bëhet shtet.

Do të duhej të mësojmë me kohë se ç'janë kiçi, shundi, gazi banal, kiçerizmi, shundërizmi, banalizmi për të marrë masa me kohë që shteti ynë, që Kosova shtet, të mos bëhet shtet kiç, shtet shund, shtet banal.

Historia na mëson se si shtetet e ardhshme më parë janë bërë shtete kiç, por historia na mëson edhe se si shtete të dinjitetshme, serioze, të zhvilluara, të forta me kohë, ngadalë, janë stërkequr dhe janë bërë shtete kiç.

Kiçi, shundi, banaliteti janë mëngjesi, dreka e darka, gëzimi dhe lartësimi i mendjeve kiç, i shpirtrave kiç!

Ruaje Zot Kosovën prej shumësisë së tyre!

23.1.2002

Televizioni ynë, KTV-ja jonë e reklamon javoren e pagëzuar *Java*.

Siç po shihet, javorja *Java* ka identitet të fortë politik, publicistik dhe, si thotë ai, kulturor.

Përbërësi themelor, qendror, i përtashëm e historik, i veçantë dhe i përgjithshëm i *Javores* është urrejtja ndaj gjuhës letrare kombëtare, të krijuar në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë në vitin 1972, dhe lufta politike dhe publicistike për kosovarishten si gjuhë standarde, si gjuhë letrare kombëtare e kombit të ardhshëm të dytë shqiptar – kombit kosovar!

Kjo gjuhë standarde, kjo gjuhë letrare kosovare është parafjala, është hyrja, është himni i kombit të ardhshëm, i quajtur kombi kosovar, i përbërë prej shqiptarëve të Kosovës, prej serbëve, malaziasve, romëve, ashkalinjve, egjiptianëve, myslimanëve, kroatëve, e gjithë pakicave të tjera që jetojnë në Kosovë.

Ruaje Zot Kosovën, ruaje Zot Shqipërinë, ruaje Zot popullin shqiptar prej politikës, ideologjisë, programit “kombëtar” të *Javës*.

29.1.2002

Kohë me diell, gati e ngrohtë.

Koha e natyrshme e kësaj kohe, zakonisht, më së shpeshti, është kohë akull e ftohtë.

Vazhdoj të merrem me tregimin për ringjalljen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Do të jetë ky Gjergj Kastriot i ri, i pamenduar, i paimagjinuar as prej armiqve, as prej kundërshtarëve, as prej miqve, as prej adhuruesve të tij: do të jetë ky Gjergj Kastrioti Skënderbeu shumë i hidhëruar dhe shumë i dëshpëruar. Sa shumë na duhet një Gjergj Kastriot Skënderbeg i këtillë, që do të merrej me prapësitë tona dhe me halabakët tanë.

30.1.2002

KTV-ja, Televizion i Kosovës, si lajm të parë jep lajmin për dorëheqjen e gazetarit Baton Haxhiu nga detyra e kryeredaktorit të gazetës së quajtur *Koha ditore*.

Mund të besohet se dorëheqja e tij është shkarkim i tij nga ajo detyrë e quajtur kryeredaktor i një gazete politike, shoqërore e kulturore.

Gjithmonë në hapësirat ballkanike janë shkarkuar e shkarkohen gazetarët e aftë e jo ata të paaftë.

1.2.2002

Prej Fakultetit Filologjik më thërrasin e më thonë: duhet të nënshkruaj listën e rrogave për dy muajt e vitit të kaluar dhe për dy muaj të këtij viti.

Iu përgjigjem:

- Jo, unë nuk kam mbajtur ligjërata në ata dy muaj dhe nuk do të mbaj as në këta dy muajt e këtij viti.

Më thonë:

- Por je i angazhuar me vendim.

Përgjigjem:

- Po, po, por pa mbajtur mësim nuk mund ta nënshkruaj listën e rrogave.

Më thonë:

- A i ke mbajtur provimet.

Përgjigjem:

- I kam mbajtur provimet, por provimet nuk mjaftojnë për të nënshkruar listën e rrogave.

Mendoj: në Institut, në Institutin Albanologjik, të cilit i kam kushtuar shumë vite të jetës, shumë mendime e shumë ndjenja, në këtë institut me ligje e pa ligje, më lanë pa rrogën që e meritoja, kurse këta duan të më japin rrogën që s'e meritoj.

Të këtilla janë moralet e çmoralet, burrëritë e zhburrëritë, ngritjet e fundosjet tona të pandalshme. Historike e të përtashme. Sidomos të përtashme.

Më dhembin eshtrat!

Më dhemb truri!

Më dhemb shpirti!

5.2.2002

Me vonesë po kuptoj se sa jam i vetëm, i vetmuar. Me vonesë do të kuptoj se sa do të jem i mallkuar.

6.2.2002

Të mirat, virtytet ia pakësojnë!

Të këqijat, veset ia shtojnë!

Mjaftueshëm si të padëshiruar ta kornizojnë!

Do të jetë protagonist shumë përshtypjebërës në romanin tim të ardhshëm.

7.2.2002

Me Agim Çekun dhe me Muharrem Mahmutajn në darkë në restorantin *Gërmia* në Gërmi.

Në darkë më ka ftuar Agimi para se të udhëtojë për në Amerikë.

Restoranti është i ri, i mirë, i bërë prej druri, në vendin e atij restorant harvallinës së përparme. Është mirë i ngrohur. Bisedojmë gjatë prej orës 20 e deri në orën 23 e 30 minuta. Agimi më bën një varg pyetjesh. Kryesorja është:

- Si mund të zgjidhet çështja e institucioneve që nuk po bëhen pasi nuk po zgjidhet kryetari (presidenti)?

I përgjigjem: - Do të mund të zgjidhet duke u propozuar kandidat tjetër nga LDK-ja, i cili do të jetë kandidat, që do ta votojnë edhe deputetët e PDK-së dhe ata të AAK-së.

Më pyet: - Çka mendoj për Malin e Zi? E për shqiptarët në Mal të Zi?

Më pyet: - Si e shoh situatën në Maqedoni?

Më pyet: - Çka mendoj për ardhmërinë e Kosovës?

Mbas përgjigjeve të mia, Agimi m'u lut të bëj një koncept për Kosovën dje e sot, që do ta paraqiste para bashkëbiseduesve gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë në Uashington, ku do të shkojë si i ftuar këto ditë.

I përgjigjem: - Mirë, do ta bëj.

Dikur vjen Ramushi. Ramush Haradinaj.

Sytë e tij tregojnë njeriun e shëndoshë, të fuqishëm, as i dehur e as esëll.

Duket se ia ka ënda rakinë!

E vazhdojmë bisedën për Shkup e Shkodër.

8.2.2002

Edhe duke punuar, natyrisht vetëm, nuk mund të mos qesh me të madhe kur e kujtoj deklaratën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Dacit, në RTK pas takimit me kënd se: nuk mora vesh me kënd!

“Kemi mendime absolutikisht identike.”!!!

Edhe “absolutikisht”, edhe “identike”!

Kjo nuk ishte marrëzia më e madhe e kësaj koke në krye të Kuvendit të Kosovës.

Marrëzitë e tij gojore dhe veprorë shtohen shpejt jo vetëm çdo javë, jo vetëm çdo ditë, por edhe çdo orë!

Një fat të tillë e ka pranuar vetë populli duke lejuar që zgjedhjet për të, në vend të tij, të popullit, t’i bëjë kryetari i LDK-së, Ibrahim Rugova.

Kur zgjedhin gomarët, ka thënë ish-ministri i Jashtëm gjerman, Joshua Fisher, sundojnë derrat.

Te ne sundojnë jo derrat e butë si Ai po derrat e egër si Ky!

9.2.2002

Janë dy intelektualë të rëndësishëm në jetën kombëtare shqiptare të cilët me vrap të rrufeshëm ikin prej së kaluarës së vet të vithisur ideologjike dhe politike.

Ikin!

Ikin!

Ikin me vrap theqafës, shumë më të shpejtë, por jo theqafës si ikanakët e tjerë, të harlisur.

Të dy kanë qenë komunistë leninistë, në të vërtetë stalinistë, kurse i pari, dikur edhe maoist.

Dhe, tani i frikëson ajo e kaluar ideologjike e politike, i frikëson duke i zvogëluar e komprometuar të dytin në mënyrë më të kulturuar, kurse të parin në mënyrë më agresive.

Për këtë arsye duan të lahen sa më rrënjësisht, aq rrënjësisht saqë ka rrezik ta rrjepin lëkurën.

Po lahem e shpërllahem edhe unë, por pa u rrjepur!

I pari po lahet e po rripet shumë më shpesh e shumë më përgjakshëm se i dyti. E kuptueshme. I ka mëkatet ideologjike dhe politike më të mëdha sesa ai. Dhe, sesa unë!

Por kot! Asnjëri nuk mund të lahet edhe në qoftë se e heq plotësisht lëkurën.

Gabova! Gabova. I Dyti, në të vërtetë, nuk ka nevojë të lahet e të shpërllahet aspak. Politika dhe ideologjia e tij e dikurshme nuk i ka lënë kurrfarë pasojash as Kosovës, as Shqipërisë, as letërsisë dhe as kulturës shqiptare. Ishin ideologji dhe politikë kohëshkurtër. Ato i kanë lënë pasoja vetëm jetës së tij: e kanë çuar në burg, duke ia bërë të pamundshme krijimtarinë letrare për të cilën kishte dhunti të madhe e me të cilën do ta pasuronte shumë letërsinë shqipe. Pasoja e ideologjisë dhe të politikës që kishte do t'i sjellin shumë vuajtje, shumë privime të gjithfarëlojshme. Atij, por shumë dinjitet dhe krenari Kosovës pse e kishte lindur atë të vendosur, atë vetëflijues dhe atë largpamës. Dhe, me moral atë të lartë.

Ideologjia dhe politika staliniste, mandej maoiste e të Dytit ishin ideologji e politikë të rrënjësishme, thelbësore të krijimtarisë së tij letrare e publicistike. Dhe me ndikim të veçantë në mendimet dhe në sjelljet e krijuesve të tjerë, me ndikim të veçantë në letërsinë dhe në publicistikën shqiptare. Dhe, jo vetëm në Shqipëri shtetërore, por kur e kur edhe në Kosovë.

Siç është dëshmuar, i Dyti ngadalë do të heqë dorë prej këtyre larjelyerjeve. Përpyekjet e tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, lavdia e tij kombëtare dhe atdhetare, është atë e madhe, atë përshtypjebërëse sa që e ka shpërbërë mëkatën e tij të dikurshëm ideologjik, që nuk ishte nënshtrues, servilizues si ai i të Parit.

E i Pari, siç po shihet, nuk e ka ndërmend të heqë dorë prej larjelyerjeve gjithnjë e më të rrënjësishme. Por, do ta kuptojë siç e ka kuptuar më në fund i Dyti:

E kaluara merr fund si e tillë dhe nuk zhbëhet, nuk ndryshohet. Do të bësh çmos ta harrosh, ta zhbësh, ta ndryshosh vetë, por nuk e harron, nuk e zhbën, nuk e ndryshon vetëdija e të tjerëve, kujtesa e atyre që e dinë, që e kanë parë, që e kanë dëgjuar si është sendërtuar ajo kur ishte e përtashme.

Dihet e thuhet: mund të ndryshojmë njerëzit, shoqërinë, shtetin, por nuk mund të ndryshojmë të Kaluarën, të Vërtetën. Sado e keqpërdorur, sado e shtypur dhe e kërcënuar ajo, e Vërteta, më në fund i fiton të gjitha betejat.

Dhe, bëhet histori.
Histori.

11.2.2001

Në mbledhjen e Këshillit për Ndërtimin e Monumentit të Lirisë.
E përbëjnë gjithsej njëmbëdhjetë vetë.

Propozova të jetë në këtë Këshill edhe dikush prej Shqipërisë.

U pajtuan - të gjithë.

Azem Syla propozoi që prej Maqedonisë të hyjë në Këshill
Arbën Xhaferi.

U pajtuam - të gjithë.

U mor vesh se propozimi i Azemit në të vërtetë ishte propozim
i Hashimit, Hashim Thaçit.

Në takimin e sotëm të Këshillit ishin edhe Arsim Bajrami,
Zenel Kelmendi, Hajrullah Gorani.

Nuk e kuptova menjëherë këmbënguljen e Azemit që unë të jem
kryetar i Këshillit. E kuptova më vonë kur Azemi tha se ai dhe unë
duhet të shkojmë shpejt në Shqipëri për të kërkuar prej Qeverisë
shqiptare ndihmë financiare për ndërtimin e Monumentit.

Thashë: Shqipëria ka shumë halle ekonomike e sociale dhe
nuk duhet të mëtojme prej saj që ta ndihmojë financiarisht edhe
ndërtimin e këtij Monumenti. Monumenti i Lirisë në Prishtinë
duhet të bëhet me paratë e shqiptarëve kudo janë ata e sidomos
të shqiptarëve në diasporë që kanë para më shumë se të tjerët në
Kosovë e në Shqipëri.

Mandej Azemi tha se unë me dikë, që do ta zgjidhnim, do
të duhej të shkonim në Amerikë për të kërkuar ndihma prej
bashkatdhetarëve të atjeshëm për Monumentin e Lirisë.

Pas këtij propozimi kuptova pse Azemi prej sa kohe nuk po
më shkoqet: do me çdo kusht që të jem në Këshill, madje kryetar
i Këshillit.

Jam i vendosur që të mos shkoj në Amerikë për të kërkuar
ndihmë prej bashkatdhetarëve të atjeshëm për ndërtimin e

Monumentit të Lirisë. Ky Monument, me rëndësi historike dhe etnike, nuk do të kushtojë aq shtrenjtë dhe duhet të ndërtohet me mjetet e bashkatdhetarëve kudo janë ata dhe me mjetet e institucioneve shtetërore të Kosovës.

12.2.2002

Në Hagë ka filluar gjykimi i kryetarit të Serbisë, më pas, edhe i Jugosllavisë së mbetur e mandej, prapë i Serbisë, i cili hyn në radhën e kriminelëve të shekullit njëzet dhe atij njëzet e një, Sllobodan Millosheviqi. Siç shihet, burgu pothuajse aspak nuk ka ndikuar në pamjen e tij: nuk duket as më i dobësuar e as më i dhjamur! Shkruhet e thuhet se nuk e vret aspak ndërgjegjja për krimet e tmerrshme që u ka shkaktuar sidomos myslimanëve të Bosnjës dhe shqiptarëve të Kosovës. Pse ta vrasë ajo që s’e ka: ata që mund të bëjnë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ata nuk mund të kenë ndërgjegje.

Me këtë rast, RTK-ja jonë ua jep mundësinë që të flasin atyre që meritojnë dhe duhet të flasin – familjarëve të atyre që janë vrasë e masakruar nga ushtria, policia, paraushtarakët dhe formacionet e tjera të armatosura serbe në Kosovë, në njërin anë si dhe ish-trabantëve kosovarë të udhëheqjes kriminale të Serbisë dhe sabotuesve e mosdrujesve të luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në anën tjetër, disa prej të cilëve me partitë e tyre po marrin pjesë edhe tani në “udhëheqjen” e Kosovës protektorat i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Si duken punët, këtyre trabantëve do t’u krijohen kushtet që edhe më vonë të luajnë rol pushtetar, sundues në Kosovë!

RTK-ja jonë është e keqpërdorur sot jo më pak sesa dje prej këtyre trabantëve të ish-Jugosllavisë e Serbisë!

Është kohë me diell.

Pluhuri të zë frymën!

Veturat i ka mbuluar dheu!

Në të gjitha anët e Prishtinës dhe, dhe, që duket si hi e pluhur në muajin më të acartë të vitit – në muajin fror, ose ndryshe në muajin shkurt. Shkurt që të duket se zgjat tepër e nuk kalon kurrë!

“Jetojmë keq! Jetojmë qençe”, më thotë shoku i vjetër i Normales dhe i studimeve, Qamili, Qamil Hasani.

13.2.2002

Marr pjesë në mbledhjen e Seksionit të Gjuhës dhe të Letërsisë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Gjuhëtari Rexhep Ismajli foli për vizitën e tij në Tiranë me ç’rast e theksoi se atje, në Tiranë, ia kanë dhënë Platformën për shënimin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit. Dhe, kanë kërkuar prej tij që këtë Platformë të mos e shumëzohet sepse ende nuk është publike. Për këtë arsye nuk e ka shumëzuar as për anëtarët e Seksionit! Nuk i thashë, kur diskutova, se atë Platformë mua ma ka dhënë anëtari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Jorgo Bulo, dhe më ka thënë që ta shumëzohet dhe t’ua jap kolegëve në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë të Akademisë sonë.

Nuk e kam ende të qartë pse gjuhëtari Rexhep Ismajli e quajti të lejueshme ta thotë një të pavërtetë, një gënjeshtër, për gjoja kërkesën që ia kanë bërë kolegët e Akademisë së Shqipërisë: për mosshumëzimin e Platformës! Besoj se më vonë do të merret vesh pse iu desh kjo gënjeshtër!

Koha është si të ishte prilli, por pa fije gjelbërimi.

Pluhuri është bërë mjegull mbi Prishtinën!

Është dita e dytë e gjykimit të kriminelit të luftës, Slllobodan Millosheviqi.

Kryetari i Gjykatës i drejtohet: Zoti Millosheviq!

Çudi!

Krimineli i luftës denjësohet me zotëri!

E pakuptueshme!

E palejueshme!

Janë tronditëse rrëfimet e familjarëve të atyre që janë vrarë dhe masakruar nga forcat serbe në Kosovë. Nuk mund të dëgjohen pa tronditje të madhe, shumë të madhe.

Fjala e prokurorit ishte rrëqethëse.

14.2.2002

Erdhën koloneli (apo gjenerali) Muçolli dhe oficeri Bedri Zymberaj pa më njoftuar. Më kanë thirrur në numrin e vjetër të telefonit, që fillon me numrin 5, kurse ky që kam tani fillon me numrin 2. Kërkojnë të flas në Ditën e Dëshmorëve për dëshmorët dhe për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Duan të konsultohen edhe se si do të ishte më mirë të quhen këto tri ditë – 5, 6 dhe 7 marsi: Epopeja e UÇK-së, siç është quajtur deri tani, Ditë të përndritura, siç propozojnë disa të tjerë apo disi ndryshe.

Meqenëse më pyetën e quajta të nevojshme t’u përgjigjem.

Emrin e këtyre tri ditëve shumë të rëndësishme, historike, duhet ta lirojmë prej patosit, që e përmban titulli i parë dhe prej spiritualizmit, që e përmban titulli i dytë. Sipas mendimit tim duhet të gjendet një emër i thjeshtë, i natyrshëm, popullor, si, fjala vjen, Ditët e dëshmorëve apo Ditët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dëshmorët dhe UÇK-ja nuk kanë nevojë për fryrje, për patos, për retorikë. Dëshmorët dhe UÇK-ja i përmbajnë të gjitha vlerat: atdhetarizmin, moralin, vetëfljimin. Patosi e retorika futen në ata emra, në ata tituj, të cilëve u mungon përmbajtja e bindshme, e vlefshme, e rëndësishme, historike. Dëshmorët dhe UÇK-ja, pra nuk kanë nevojë, aspak, kurrë, për to: për patosin dhe retorikën.

Sa i përket Akademisë, që duhet të mbahet në Teatër, më intereson çka krejt do të përmbajë ajo Akademi dhe kush krejt do të flasë aty?

Koloneli Muçolli më thotë: është biseduar që pas meje, Rexhep Qosjes, Hashim Thaçit dhe një historiani të flasë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci.

Përgjigjem: në akademitë, në të cilat qe tre vjet përkujtohet lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po flasin shumë njerëz njëri pas tjetrit. Sipas mendimit tim do të ishte më mirë të flasin më pak njerëz, dy a tre, dhe të ketë më shumë program foljor dhe artistik: recitime, recitale, këngë, fragmente muzikore, edhe baleti – pse jo. Sa më përket mua, ju falënderoj për ftesën që të paraqitem në këtë akademi. Nuk më duket e arsyeshme,